

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**  
**VENDIM**

**Nr. 56, datë 31.03.2026**

**PËR**  
**MIRATIMIN E RIEMËRIMIT TË ANËTARIT TË KËSHILLIT TË ADMINISTRIMIT**  
**TË SHOQËRISË “CREDINS INVEST” SH.A - SHOQËRI ADMINISTRUESE E**  
**FONDEVE TË PENSIONIT PRIVAT DHE SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE**  
**KOLEKTIVE**

Në mbështetje të nenit 14, pika 22, të ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, neneve 15 dhe 17, të ligjit nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat”, neneve 14 dhe 15 të ligjit nr. 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, rregullores nr. 112, datë 31.08.2020 “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, licencimin dhe regjistrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisë”, si dhe rregullores nr. 1, datë 31.01.2024, “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërisë administruese të fondeve të pensionit privat dhe depozitarit të fondeve të pensionit privat të themeluara në Republikën e Shqipërisë”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

- 1. Miratimin e riemërimit të zj. Armira Çitozi, në pozicionin e anëtares së Këshillit të Administrimit “Credins Invest” sh.a - shoqëri administruese e fondeve të pensionit privat dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive, deri më datë 22.01.2029.**
- 2. Ngarkohen Drejtoria e Licencimit, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR**

**Saimir TOLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

**Adela XHEMALI**